

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Mirëmbajtja e godinave të arsimit.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **50000000-5, Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi.**

VLERA E FONDIT LIMIT: **6 661 473** (gjashtëmilion e gjashtëqindëgjashtëdhjetenjë mijë e katërqindësdhjetetë) **Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për ekzekutimin e kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente: Kategoria NP-3, Klasifikimi A, Emërtimi “Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godina civile e industrial, veshje fasada”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës” dhe nenin 41, pika 4, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Në bazë të liçencës profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që prokurohet dhe pikat e kërkuara të licensës janë përcaktuar nga vlera e shërbimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e shërbimeve që do të kryhen sipas zërave të preventivit. Kategoria NP3, emërtimi “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godina civile e industrial, veshje fasada” është përcaktuar bazuar në objektin e prokurimit që është “Mirëmbajtja e godinave të arsimit”. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 000 000 lekë, është zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” që i përgjigjet kësaj vlere

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP të ndryshuar, nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet

ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”*.

Në nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”*.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës *“Procedurë e hapur të thjeshtuar”* edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, ku parashikohet se *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”*, nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* të ndryshuar, ku përcaktohet se *“Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”*.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit.

Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e shërbimeve të ngjashme me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- bojaxhi 1 (një)
- hidraulik 1 (një)
- elektrikist 1 (një)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

- Kontratë Individuale të Punës (të vlefshme)
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme), të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi të njohur nga Republika e Shqipërisë, Institucione Shtetërore ose organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.....Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës: bojaxhi, hidraulik, elektrikist. Personeli kryesor është përcaktuar bazuar në zërat e shërbimeve të cilat përfshijnë, midis të tjerave, instalime hidro-sanitare dhe ngrohje, bojatisje dhe instalime për ndriçim.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 20 (njëzetë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

Listëpagesës sipas formularit standart për sigurimet për muajin Qershor 2025.

Vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për muajin Qershor 2025.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.....Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 41, pika 4/ b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listëpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Sasia e orëve të punës mbështetur në preventiv, manualin e çmimeve të ndërtimit dhe analizat e kostove është $5\,760 \text{ orë} : 8 = 720 \text{ ditë pune}$. Afati 40 ditë kalendarike. Atëherë $720:40=18$ punëtorë dhe duke shtuar stafin drejtues (administrator dhe inxhinier ndërtimi etj) është gjykuar për të kërkuar 20 punonjës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Kamion vetëshkarkues me vinc kapacitet mbajtës (mbi 5 ton)	1 copë	Pronësi ose me qira
Skela	500 m ²	Pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi
Motobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qira
Depozitë uji >= 5000 litra	1 copë	Pronësi ose me qira
Kokore	10 copë	Pronësi ose me qira
Kuti e ndihmës së shpejtë	10 copë	Pronësi ose me qira

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit;
- leje qarkullimi;
- çertifikaten e kontrollit teknik;
- siguracionin e mjetit.

b) Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e tij;
- leje qarkullimi;
- çertifikatën e kontrollit teknik,
- siguracionin e mjetit.

Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës që prokurohet dhe afati i saj.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Mjetet dhe pajisjet teknike e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedura të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” dhe nenin 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është përcaktuar duke u bazuar në zërat e preventivit dhe specifikimeve teknike. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset sipas zërave përkatës të preventivit. Përcaktimi i pajisjeve dhe makinerive është bërë duke marrë në konsideratë volumet e shërbimeve për secilin zë si dhe hapësirat fizike rreth objektit, mundësive të manovrimit me mjete, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes, Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se shërbimet do të realizohen me cilësi.

2.3.5 Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se shërbimet, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

- *Certifikatë e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015;*
- *Certifikatë e sistemit të menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015;*
- *Certifikatë për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001-2018*
- *Çertifikatë e sistemit të integruar të menaxhimit BS PASS 99:2012*

Në rastet e bashkimit ekonomik të operatorëve, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë përkatësisht Certifikatën ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Kontratës së Bashkëpunimit.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale”*

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara

nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”, nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lid, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit”.

Duke marrë në konsideratë faktin se standarti S SH EN ISO 14001:201, “Sisteme të menaxhimit të mjedisit”, SSH EN ISO 9001: 2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” dhe SSH EN- ISO 45001:2023 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë” dhe PASS 99:2012 “Sistemi i menaxhimit të integruar”, specifikojnë kërkesat për sistemin e menaxhimit të mjedisit, sistemin e menaxhimit të cilësisë, sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe sistemin e menaxhimit të integruar, për t’i krijuar mundësinë një organizate të zhvillohet dhe të implementojë (ose zbatojë) një politikë dhe objektiva të cilat marrin parasysh kërkesat ligjore dhe kërkesa të tjera në lidhje me aspekte të rëndësishme mjedisore, vlerësohet se plotësimi i këtij standarti lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri që shërbimet do të jenë konform standarteve të kërkuara, për mbrojtjen e mjedisit ku do të përdoren, mbrojtje e cila ndihmon në parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të banorëve apo garantimin e kryerjes me cilësi të punimeve dhe mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve dhe jo vetëm.

Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, të mjedisit, i sigurisë në punë dhe menaxhimit të integruar janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjës për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Kriteri i mësipërm për paraqitjen e këtyre certifikatave është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga Sektori i Mirëmbajtjes së Infrastrukturës Rrugore, Sektori i Menaxhimit të Aseteve dhe Sektori i Mirëmbajtjes së Aseteve Publike për shërbimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Nr	Kodi	Emërtimi i shërbimeve	Njësia	Sasia
		1. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE		
1	2.515	F.V. piletë dysHEMEJE Ø 50	copë	10
2	2.501	F.V. WC allafrënga	copë	6
3	2.495	F.V. lavaman porcelani	copë	5
4	2.491/2a	F.V. tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=20mm, t = 2.0 mm, Pn 10	ml	150
5	2.491/2b	F.V. tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=25mm, t = 2.0 mm, Pn 10	ml	200
6	2.491/2c	F.V. tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=32mm, t = 2.4 mm, Pn 10	ml	150
7	2.491/1b	F.V. tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=25mm, t = 3.0 mm, Pn 20	ml	150
8	2.491/1c	F.V. tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=32mm, t = 3.6 mm, Pn 20	ml	300
9	2.215	F.V. bolier 80 litër, ujë të ngrohtë	copë	1
10	2.217	F.V. bolier 12 litër, ujë të ngrohtë sanitar	copë	2
11	2.210	F.V. rezervuari zingato 2000 litra	copë	2
12	2.615	Heqje pajisje hidrosanitare	copë	45
		2. PUNIME BETONI DHE B/A		
13	2,121	Breza b/a monolit C 16/20	m ³	5
		3. PUNIME BOJATISJE		
14	2.399	Sherbetisje e bojatisje me gëlqere	m ²	1,000
15	2.404/1	Bojë hidroplastike cilësi e lartë	m ²	5,000
16	2.403	Bojë vaji mbi sipërfaqe të patinuar	m ²	500

17	2.431	Skelë me tubo fasade ~ 8m	m ²	1,600
		4. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI		
18	2.328/1	Patinim muri me stuko	m ²	300
19	2.330/1	Patinim tavani me stuko	m ²	150
20	2.601	F.V. rrjeta për skelën	m ²	1,600
		5. PUNIME SHITESASH 2		
21	2.586	Shtresë llaç-çimento t=8cm	m ²	150
22	2.697	Rrashnim parketi	m ²	250
23	2.702	Shtresë moketi	m ²	80
24	2.281	Heqje pllaka dysHEMEJE	m ²	150
		6. INSTALIME PER NDRICIM		
25	2.483	F.V. çelësa e priza 10 A	copë	150
26	2.485	F.V. çelësa e priza 10 A me nulifikim	copë	150
27	2.481/1	F.V. përcjellës PV-500 Ø 1.5 mm ²	ml	1000
28	2.481/2	F.V. përcjellës PV-500 Ø 2.5 mm ²	ml	1,500
29	2.489	F.V. siguresa ~ 25 A	copë	100
30	2.485/e	F.V. priza shuko jashtë murit 2P+T IP=54	copë	50
31	2.458	F.V. Ndricules fluoreshent 1x40ë.IP65	copë	80
		7. GAZ E NAFTËSJELLËS		
32	4.155/4	F.V. kuti shpërndarëse me kapak plastik 118x96x50mm	copë	150
		8. NËNSHTRESA DHE SHITESA NË TERRITORIN E NDËRTESAVE		
33	2.274	Shteresë çakëlli i imët	m ³	15
		9. ANALIZA JASHTË LISTE		
34	An1	Shërbime, riparime/mirëmbajtje, dyer/dritare&MKZ;	op	1

1. F.V. piletë dysHEMEJE Ø 50:

Për shkarkimin e ujërave të dysHEMEJEVE do të përdoren pileta të cilat plotësojnë të gjitha kërkesat e cilesisë sipas standartit ISO dhe prEN12201. Piletat mund të jenë me material plastik, inoksi ose bronxi. Përmasat 100x100x85mm, materiali pvc me përfundim grilë me diametër ø90 dhe kornizë

bronx/inoksi e orientuar, vëllimi i ujit 20lt/min.

2. F.V. WC allafrënga:

F.v WC allafrënga, janë në përputhje me pajisjet ekzistuese. Pajisjet e reja do të jenë prej porcelani të emaluar, me ngjyrë të bardhë dhe të kompletuar me të gjithë aksesorët. WC janë të tipit allafrënga së bashku me kasetën e shkarkimit dhe pajisjet fiksuese. Mbushja e hapësirave pas vendosjes dhe fiksimit bëhet me silikon transparent.

3. F.V. lavaman porcelani:

F.v lavaman importi janë në përputhje me pajisjet ekzistuese. Pajisjet e reja do të jenë prej porcelani të emaluar, me ngjyrë të bardhë dhe të kompletuar me të gjithë aksesorët. Lavamani do të jetë me mishelator të ujit të ngrohtë dhe të ftohtë, kollonën prej porcelani, sifonin e shkarkimit me guarnicionet. Mbushja e hapësirave pas vendosjes dhe fiksimit bëhet me silikon transparent.

4. 10F.V. tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=20mm, t = 2.0 mm, Pn 10:

F.V. linja ujësjellësi me përdorim tuba polietileni presioni nominal 10bar dhe diametrit 20mm me spresor 2mm me rakorderitë përkatëse sipas nevojave. Amballazhuar në sasi të 25/50ml dhe të çertifikuar me ISO.

5. F.V. tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=25mm, t = 2.0 mm, Pn :

F.V. linja ujësjellësi me përdorim tuba polietileni presioni nominal 10bar dhe diametrit 25mm me spresor 2mm me rakorderitë përkatëse sipas nevojave. Amballazhuar në sasi të 50ml dhe të çertifikuar me ISO.

6. F.V. tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=32mm, t = 2.4 mm, Pn 10:

F.V. linja ujësjellësi me përdorim tuba polietileni presioni nominal 10bar dhe diametrit 32mm me spresor 2.4mm me rakorderitë përkatëse sipas nevojave. Amballazhuar në sasi të 25/50ml dhe të çertifikuar me ISO.

7. F.V. tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=25mm, t = 3.0 mm, Pn 20:

F.V. linja ujësjellësi me përdorim tuba polietileni presioni nominal 20bar dhe diametrit 25mm me spresor 3mm me rakorderitë përkatëse sipas nevojave. Amballazhuar në sasi të 25/50ml dhe të çertifikuar me ISO.

8. F.V. tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=32mm, t = 3.6 mm, Pn 20:

F.V. linja ujësjellësi me përdorim tuba polietileni presioni nominal 20bar dhe diametri 32mm me spresor 3.6mm me rakorderitë përkatëse sipas nevojave. Amballazhuar në sasi të 25/50ml dhe të çertifikuar me ISO.

9. F.V. bolier 80 litër, ujë të ngrohtë:

Konsiston në zëvendësimin e boilerëve 80 litra të dëmtuar, me boiler 80 litra të rinj, duke siguruar që heqja dhe montimi i tyre të bëhet sipas kushteve teknike.

10. F.V. bolier 12 liter, ujë të ngrohtë sanitar:

Konsiston në zëvendësimin e boilerëve 12 litra të dëmtuar, me boiler 80 litra të rinj, duke siguruar që heqja dhe montimi i tyre të bëhet sipas kushteve teknike.

11. F.V. rezervuari zingato 2000 litra:

F.V. rezervuar për ujin sanitar kapaciteti 2000lt. Rezervuari i ujit shërben për të akumuluar ujin sanitar. Përbërja e rezervuarit është prej llamarine zingato e lyer me agjentë anti-korrozivë. Trashësia e materialit të llamarinës llogaritet në varësi të volumit të rezervuarit dhe formës së tij, por në rastin tonë varion 1–1.5 mm. Rezervuari duhet të montohet dhe të jetë i pajisur me pompë për të siguruar presionin dhe prurjen e duhur gjatë gjithë ditës në një ndërtesë mund të vendosen

pompa uji të tipit centrifugal. Pompat duhet të jenë të pajisura me matësin e ujit, matësin e presionit, tubat përkatës të lidhjes së pompës me sistemin e ujësjellësit, panelin elektrik përkatës të tyre, me sistemin e mbrojtjes rele, të mbrojtjes termike, si dhe me sistemin e kontrollit automatik të punës.

12. Heqje pajisje hidrosanitare:

Heqja e pajisjeve h/sanitare dhe sistemit i materialit që rezulton, brenda ambientit të objektit, duke përfshirë përzgjedhjen e mundshme dhe vënien nënjanë në një vend të caktuar të objektit për ripërdorim. Çmontimi dhe heqja e pajisjeve hidrosanitare do kryhet nga specialistë.

13. Breza b/a monolit C 16/20:

Betoni duhet të jetë i M-200. Duhet të derdhet në forma(kallup) direkt mbi mur dhe të vibrohet mirë, duke përfshirë hekurin e armaturës, kallëpet, përforcimet, si dhe çdo detyrim tjetër me mjeshtëri për mbarimin e punës. Hedhja e betonit në vend bëhet sipas mundësive dhe kushteve ku ai do të hidhet brezat e betonit duhet të jenë armuar me 4 Ø10 fije gjatësore dhe stafa tërthore 5 Ø8. E rëndësishme në procesin e hedhjes së betonit në vepër është koha nga prodhimi në hedhje, e cila duhet të jetë sa më e shkurtër. Gjithashtu, një rëndësi të veçantë në hedhjen e betonit ka edhe vibrimi sa më mirë gjatë këtij procesi. Matja do të jetë në m³.

14. Sherbetisje e bojatisje me gëlqere:

Në fillim të procesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqere të holluar (astari). Në fillim bëhet përgatitja e astarit duke përzier 1 kg gëlqere me 1 litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë. Norma e përdorimit është 1 litër gëlqere e holluar duhet të përdoret për 2 m² sipërfaqe.

Më pas vazhdohet me lyerjen me bojë gëlqere si më poshtë: Bëhet përgatitja e përzierjes së bojës të lëngshme me ujë. Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20 – 30 %. Kësaj përzierje i hidhet pigment derisa të merret ngjyra e dëshiruar. Bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë i holluar në 2.7 – 3 m² sipërfaqe (në varësi të ashpërsisë së sipërfaqes së lyer).

15. Bojë hidroplastike cilësi e lartë:

Para lyerjes duhet të bëhet kruajtja e ashpër e bojës së mëparshme nga sipërfaqja e lyer, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të mbushjes dhe stukimi i riparimeve. Përpara fillimit të procesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dritare, etj.) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse. Pasi të stukohen sipërfaqet përpara lyerjes do të trajtohen me prajmer. Prajmeri është me përbërje silikon akrilik, me bazë uji gjysëmtransparent dhe ekologjik. Është i përshtatshëm për përdorim në ambiente të brendshme dhe të jashtme, me veti hidroizoluese dhe nuk përmban amoniak apo substanca të tjera të rrezikshme, siç janë hidrokarburet aromatike, metale të rënda.

Boja përpara përdorimit duhet të hollohet me ujë deri në masën 10%. Ngjyrat do të përcaktohen nga autoriteti kontraktor.

Të dhënat teknike të bojës:

Viskoziteti: 105 -110 ± 10 KU (ASTM D 562, 25o C) ose ekuivalent

Densiteti: 1,40 – 1,48 ± 0,02 Kg/L (ISO 2811) ose ekuivalent

Aftësia mbuluese: 11 - 13 m² /L

Boja duhet të përmbushë standartet:

Standartin “EU ECOLABEL” (Ekologjik) sipas Direktives Europiane 2014/312/EEC ose

ekuivalent.

Standartin antibakteriale sipas ISO 22196 ose ekuivalent.

16. Bojë vaji mbi sipërfaqe të patinuar:

Lyerje me bojë vaji në rikonstrukcion. Përpara bojatisjes, bëhet ashpërsimi i sipërfaqeve të vjetra dhe stukimi i gropave, çarjeve, plasaritjeve me zgjerimin e tyre para mbushjeve. Lyerje me bojë vaji sintetik për patinime, me dozim për m²: bojë vaji 0.2 kg dhe me shumë duar, për të patur një mbulim të plotë dhe perfekt të sipërfaqeve si dhe çdo gjë të nevojshme për mbarimin e plotë të lyerjes me bojë vaji.

17. Skelë me tubo fasade ~ 8m:

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skelëritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

18. Patinim muri me stuko:

Patinurë muri realizohet me stuko, çimento dhe gëlqere të cilësisë së lartë mbi sipërfaqe të suvatuara më parë dhe të niveluara, me përmbajtje gëlqere 3kg për m².

19. Patinim tavani me stuko:

Patinurë tavani realizohet me stuko, çimento dhe gëlqere të cilësisë së lartë mbi sipërfaqe të suvatuara më parë dhe të niveluara, me përmbajtje gëlqere 3kg për m².

20. F.V. rrjeta për skelën:

F.V. rrjete, për të siguruar skelat, veshja e të gjithë skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik. Kontraktori duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperiencë, të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelerive dhe të mbikëqyrë punën për ngritjen e skelave në kantier.

21. Shtresë llaç-çimento t=8cm:

Riparimi i dyshemesë me lustër çimento duhet bërë në këtë mënyrë; Më së pari duhet të lokalizohen pjesët e dëmtuara të lustër çimentos. Pastaj duhet që në ato pjesë që ka dëmtime të vizatohet një katërkëndësh dhe dyshemeja të pritët deri në një thellësi prej të paktën sa është thellësia e dyshemesë. Ajo pjesë e vizatuar duhet të hiqet me mjete mekanike dhe vendi të pastrohet nga pluhuri si dhe të lahet në ujë me presion. Para se të hidhet në gropën e hapur pjesët anësore të saj lyhen me një solucion i cili ndihmon ngjitjen e lustër çimento me shtresën e betonit.

22. Rrashnim parketi:

Në parketet ekzistuese do kryhen punime llustrimi dhe riparime të dëmtimeve. Rrashnimi i sipërfaqes me pajisje dore ose me makinei, parapërgatitja për llustër, llustrimi i saj me bojë.

23. Shtresë moketi:

Moketi të perdoret në ambjente të brendshme: zyra, korridore, ambjente, çerdhe dhe kopshte etj. Materiali të jetë polyester 70% dhe 30% Nailon. Trashësia të jetë (3-7)mm ndërsa formati rulo ose dimensione të tjera. Të jetë lehtësisht i pastrueshëm me vakum.

24. Heqje pllaka dysHEMEJE:

Prishje e veshjeve të çfarëdo lloji dhe prishje e llaçit që ndodhet poshtë, pastrim, larje, duke përfshirë largimin e materialeve jashtë ambientit të kantierit, si dhe çdo detyrim tjetër.

25. F.V. çelësa e priza 10 A:

Konsiston në zëvendësimin e çelësave të ndriçimit të dëmtuara dhe jashtë funksionit me çelësa të thjeshtë 10 A, duke i montuar në kuti brenda murit, sipas kushteve teknike.

26. F.V. çelësa e priza 10 A me nulifikim:

Konsiston në zëvendësimin e çelësave të ndriçimit të dëmtuara dhe jashtë funksionit me çelësa të thjeshtë 10 A, duke i montuar në kuti brenda murit, sipas kushteve teknike.

27. F.V. përcjellës PV-500 Ø 1.5 mm²:

Përcjellesat elektrik duhet të jenë në përputhje me standardin S SH EN50575 për furnizimin me energji elektrike në ndërtim civil dhe lidhjet e brendshme të ndryshme. Duhet të jenë me izolim të jashtëm PVC fleksibël të cilësisë S17, dhe me material përcjellësi bakër të klasit 5. Tensioni nominal $U_0 > 450$ V, Tensioni nominal $U > 750$ V, Tensioni i provës > 3000 V, Temperaturë maksimale pune > 70 °C, Temperatura maksimale për LSH > 160 °C, Temperaturë minimale pune < -10 °C, Forca maksimale në tërheqje > 50 N/mm².

28. F.V. Përcjelles PV-500 Ø 2.5 mm²:

Përcjellesat elektrik duhet të jenë në përputhje me standardin S SH EN50575 për furnizimin me energji elektrike në ndërtim civil dhe lidhjet e brendshme të ndryshme. Duhet të jenë me izolim të jashtëm PVC fleksibel të cilësisë S17, dhe me material përcjellësi bakër të klasit 5. Tensioni nominal $U_0 > 450$ V, Tensioni nominal $U > 750$ V, Tensioni i provës > 3000 V, Temperaturë maksimale pune > 70 °C, Temperatura maksimale për LSH > 160 °C, Temperaturë minimale pune < -10 °C, Forca maksimale në tërheqje > 50 N/mm².

29. F.V. Siguresa ~ 25 A:

Konsiston në zëvendësimin e siguresave 25A të linjës elektrike të dëmtuara dhe jashtë funksionit me siguresa 25A të reja të njëjtë me ata të hequr, duke i montuar sipas kushteve teknike.

30. F.V. Priza shuko jashtë murit 2P+T IP=54:

Priza Shuko ngjyra e përcaktuar nga investitori • Tensioni: 250 V AC • Rryma: 2P+E - 16 A • Tokëzimi: Në krahë dhe në qendër • Diametri i spinave: Ø4/4.8/5mm • Tipi i Prizes: P40 • Rezistenca në tensionin e testit: 2000V në 50Hz për 1 minute • Rezistenca e izolimit: > 5 MOhm • Standarti: IEC60884-1 ose ekuivalent • Kapacitetet e shtrëngimit të terminalit kabllot e përdredhshëm: 0,75-2x4 mm² • Kapacitetet e shtrëngimit të terminalit kabllot solid: 0,5-2x5 mm².

31. F.V. Ndriçues fluoreshent 1x40w.IP65:

Konsiston në ndërimin e ndriçuesve tavanorë 40w të dëmtuara dhe jashtë funksionit me ndriçues të rinj të njëjtë me ata të hequr, duke i montuar sipas kushteve teknike.

32. F.V. Kutit shpërndarëse me kapak plastike 118x96x50mm:

Kutit elektrike shpërndarëse përmasave 120x100x50mm përdorim të jashtëm në instalimet e shtesave me energji elektrike për priza.

33. Shtresë çakëlli i imët:

Çakëll makinerie e prodhuar nga thyerja dhe fraksionimi në makineri të materialeve gurore ose zhavorre lumi me fortësi 800 kg/cm² dhe të respektojë kushtet teknike të Standartit Shqiptar STASH-512-78 ose në përputhje me ASTM C 33 "Inertët e betonit nga burime natyrore" dhe të mos ketë përmbajtje të huaj argjilore më shumë se 5% dhe material organik jo më shumë se 3%.

Çakelli i makinerisë duhet të ketë granulometrinë (10-20)mm.

34. Shërbime, Riparime/mirëmbajtje,dyer/ dritare&MKZ:

Fikeset e zjarrit portative vendosen brenda ndërtesave. Tipe portative janë bombulat e ndryshme. Bombël e lyer me bojë ngjyrë të kuqe (RAL 3000) e lëvizshme me pluhur. Mund të përdoret për fikjen e zjarrit në pajisjet elektrike si dhe rreth tyre pasi është jo përcjelle. Përdoret vetëm një herë. Janë efektiv dhe në fikjen e zjarreve që përfshin klasa B e zjarrit. Kapaciteti Normal 6kg. Dimensionet Ø 140 x 765 mm.

Riparime në dyer, dritare, pllaka në W.C. Zëvendësime në përputhje me ato ekzistuese në: mentesha, brava, doreza, stukime dhe lyerja e dyerve të dëmtuara, panele xhami të dëmtuara dhe pllaka qeramike. Punime mirëmbajtje druri-hekuri e marangozi, ku përfshihen punime për dyer d/alumini tek xham, dritare d/alumini dyfish xham, dyer të brendshme tamburate të rimesuara, dryn, fishekë për derë druri, bravë për derë druri, ndërrim fishekësh druri dhe duralumini, brava druri dhe duralumini, doreza dere duralumini, doreza dere druri/ tamburato. Mentasha dere e blinduar, derë druri, dollap, komodina, shula për dritare dhe dyer, xhama të thjeshtë, dopjo.

Afatet e realizimit të punimeve: Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 40 (dyzetë) ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës.

Në përfundim njësia e prokurimit;

Vendosi:

1. Miratimin e kriterëve të veçanta të procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtja e godinave të arsimit”.
2. Miratimin e specifikimeve teknike të objektit “Mirëmbajtja e godinave të arsimit”.
3. Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, neni 45, pika 2, kriter vlerësues të jetë: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.
4. Procedura për hapjen e ofertave do të zhvillohet në datën 11.08.2025, ora 11⁰⁰

NJËSIA E PROKURIMIT